



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Lushnjë, më _____.2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “ Sistemime rrugore në lagjen “18-Tetori”,ndërmjet rrugëve
“Hysni Gorovelli” dhe “Athina Dhimitri”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7 –
Punë ndërtimi**

VLERA E FONDIT LIMIT: 34 999 989.72 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e dy) **Lekë pa TVSH**
dhe **41 999 987.65** (dyzet e një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë presje gjashtëdhjetë e pesë) **Lekë me TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Lushnjë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim, për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se : 34 999 989.72 (tridhjetë e katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë presje shtatëdhjetë e dy) Lekë pa TVSH** ,(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare **2023, 2024**, të konfirmuara nga organet tatimore, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, ku bilancet e këkuara nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:***

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrijn ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrijn ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar, si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore të lëshuara nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetin **për vitin e fundit (këstet e maturuara)** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për **vitin e fundit (këstet e maturuara)**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT.

Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR”, i ndryshuar.

Meqënëse operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **17 499 994.9** (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër presje nëntë) **Lekë pa Tvsh**, (50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet), dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,
ose,
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është jo më e vogël se **69 999 979.4** (gjashtëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje katër), **Lekë pa Tvsh** (dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet)

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudit;

- Certifikaten e marrjes ne dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Akt kolaudimi objekti;
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes ne dorezim.
 - Fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe punët e realizuara me sukses.

pika 2.3.1 duhet të plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose minimalisht sa dyfishi i fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve.

2.4 Licenca profesionale të operatorit për realizimin e objektit të kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore ose ekuivalente me licencat profesionale ndërkombëtare në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj;

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licensë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **N.P. 4 B** (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)
- **N.S. 6 A** (Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)
- **N.S. 18 A** (Punime topogjeodezike)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P. 4 B	(Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale)	Për punime në rrugë pavarësisht nga shkalla e tyre e vështirësisë. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit.	21-50
N.S. 6 A	(Sinjalistika rrugore jo ndriçuese)	Për vendosjen në vepër të sinjalistikës rrugore jo ndriçuese, vertikale dhe vertikale. Kjo gjë është e pasqyruar edhe në preventivin e objektit	0-20
N.S. 18 A	(Punime topogjeodezike)	Për punime topogjeodezike të nevojshme gjatë kryerjes së punimeve në të gjitha proceset dhe piketimin e rrugës Për këtë gjë është kërkuar ky zë licence.	0-20

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

2.4.1 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse, si dhe te figuroje ne listepagesat e shoqerise,konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (një) Teknik Ndertimi
- 1 (një) Topograf
- 2 (dy) Elektracist
- 2 (dy) Saldator

- 2 (dy) Karpentier

Per te vertetuar personelin duhet:

- Për stafin e sipërcituar të paraqitet dokumentacion që vërteton profesionin si: diplomat e inxhinierëve, dëshmi profesionale ose ekuivalenti i tij/saj dhe kontrata pune, diplomat ose kualifikimet për punonjës të specializuar/të kualifikuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.4 kapaciteti teknik në DST. Stafi teknik (në bashkëpunim me stafin inxhinierik, si dhe fuqinë tjetër punëtore) do jetë përgjegjës për të ekzekutuar kontratën objekt prokurimi në zbatim të plotë me Projektin e zbatimit si dhe brenda afatit të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik. Kërkesa për stafin teknik është mbështetur gjithashtu në “Rregulloren e sigurimit dhe shfrytëzimit teknik për impiantet, pajisjet dhe instalimet elektrike” ku janë përcaktuar edhe kategoritë e dëshmimeve të kualifikimit të sigurimit teknik.

- 2.4.2** Operatori ekonomik ofertues, me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të përcaktojë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë me profesion inxhinier ndërtimi dhe të deklarojë se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Bashkelidhur deklaratës për Drejtuesin Teknik duhet të paraqitet; a) Kontrata e punës e vlefshme dhe b) Diploma. Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt se ai është i disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkëpunimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se

operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie” ne nenin 39, pika 6, gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe ligjin 8402 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” datë 10.09.1998, i ndryshuar.

2.4.3 Një punësim mesatar i të paktën **18 (tetëmbëdhjetë)** personave, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajtë e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore per periudhen e fundit te deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per periudhen e fundit te deklaruar.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, I ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument qe vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te **18 (tetëmbëdhjetë)** personave duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet.*

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (Ndryshuar me VKM Nr. 631, datë 26.10.2018). Bazuar ne katër elementët e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport) zëri fuqi puntore zë rreth 20% të kostos.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.5 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- a) Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të siguri dhe shëndetit **ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).
- c) Çertifikatën e menaxhimit të siguri së qarkullimit rrugor **ISO 39001 – 2012** (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas Marrëveshjes së bashkëpunimit).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “c” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë*

akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci ekstra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 është standard ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor (RTS). AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 39001:2012 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje me sistemin e qarkullimit rrugor, si dhe të reduktojë apo përjashtojë rreziqet e humbjes së jetës dhe plagosjeve të rënda në aksidentet e qarkullimit rrugor. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (ndërtim rruge) ku mundësia për ngarkesën e trafikut rrugor është e lartë, me qëllim minimizimin e këtij risku, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me ISO 39001:2012.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **147 (njëqind e dyzet e shtatë) ditë kalendarike**.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3.

2.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Eskavator me goma min 0.25 m ³	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamionë vetëshkarkues min 5 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qira

Rrul kompresor me vibrim	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobot uji	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qira
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qira
Fabrikë asfaltobetonit	1 copë	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi
Traktor Tërheqës	1 copë	Pronësi ose me qira
Autovinç deri 5 ton	1 copë	Pronësi ose me qira
Spërkatës boje për vijëzime në rrugë	1 copë	Pronësi ose me qira
Ekskavator min 2 m ³	1 copë	Pronësi ose me qira
Kamioncinë deri 3.5 ton	2 copë	Pronësi ose me qira
Vibrator	1 copë	Pronësi ose me qira
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qira
Fabrikë betoni	1 copë	Pronësi, me qira ose aktmarrëveshje furnizimi
Kallëpe	Min 400 m ²	Pronësi ose me qira
Fadrom	1 copë	Pronësi ose me qira
Betoniere min 0.5 m ³	1 copë	Pronësi ose me qira
Elektrosaldatriçe	1 copë	Pronësi ose me qira

- (a) Për mjetet që shënohen në regjistra publik , kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit, më konkretisht: leja e qarkullimit; certifikatën e pronësisë; certifikatën e kontrollit teknik; policën e sigurimit (siguracionin) e vlefshme; Certifikatën e transportit e vlefshme; taksat vjetore dhe fotot përkatëse në secilën anë të mjetit/pajisjes, ku në rastet e mjeteve të targuara në foto duhet të jetë e dukshme dhe targa e mjetit;
- (b) Për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e punimeve ,deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publik, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- (d) Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- (e) Per fabriken e betonit duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e saj, kontrata e marrjes me qera te saj ose aktmarrëveshja për furnizim.
- (f) Per fabriken e asfaltobetonit duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine e saj, kontrata e marrjes me qera te saj ose aktmarreveshja per furnizim.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nepermjet ketyre kërkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kanë në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Ekskavator me goma min 0.25 m³ (copë 1)

Për gërmimin e materialeve, në preventiv janë 2085 m³ gërmim dheu me ekskavator,

Kamionë vetëshkarkues min. 5 ton (copë 2)

Këto mjete do të përdoren për largimin e materialit të gërmuar dhe sjelljen e materialeve të kërkuara të objektit. Në preventiv kemi transport materiale ndërtimi, dheu 2105 m³, shtresë çakëlli t=10 cm 6115 m², shtresë stabilizanti t=5 cm 1105 m², shtresë stabilizanti t=10 cm 5180 m², shtresë binderi t=5 cm 3440 m², shtresë binderi t=6 cm 735 m², shtresë asfaltbetoni t=3 cm 3440 m², mbushje me çakëll e gur gurore 310 m³, mure butobetoni C 16/20 - 55 m³, mure guri 54 m³, nënshtresë rëre 18 m³, shtresë zhavori lumi t=20 cm 24 m², bordura betoni 15x30 cm 910m, trotuar me pllaka 951 m², tuba betoni Ø 200 mm 200 ml, tuba betoni Ø 300 mm 650 ml, tuba betoni Ø 400 mm 600 ml, mbushje me çakëll pas mureve 655 m³,

Grejder (copë 1)

Për shpërndarjen dhe nivelimin e materialit të nënshtresave. Në preventiv janë shtresë çakëlli t=10 cm 6115 m², shtresë stabilizanti t=5 cm 1105 m², shtresë stabilizanti t=10 cm 5180 m²,

Rrul kompresor me vibrim (copë 1)

Mjet që përdoret për njëtrajtësimin e shtresave të rrugës. Në preventiv kemi shtresë çakëlli t=10 cm 6115 m², shtresë stabilizanti t=5 cm 1105 m², shtresë stabilizanti t=10 cm 5180 m², shtresë binderi t=5 cm 3440 m², shtresë binderi t=6 cm 735 m², shtresë asfaltbetoni t=3 cm 3440 m², mbushje me material të gërmuar 450 m³, mbushje me çakëll e gur gurore 310 m³,

Autobot uji (copë 1)

Për sjelljen e sasisë së nevojshme të sasisë së ujit që nevojitet për kryerjen e proceseve të ndryshme të punëve që kërkohen si në shtresë stabilizanti t=5 cm 1105 m², shtresë stabilizanti t=10 cm 5180 m², mbushje me material të gërmuar 450 m³, mbushje me çakëll e gur gurore 310 m³,

Autobitumatrice (copë 1)

Duhet për shpërndarjen e emulsionit të bitumit gjatë procesit të asfaltimit. Në preventiv kemi shtresë binderi t=5 cm 3440 m², shtresë binderi t=6 cm 735 m², shtresë asfaltbetoni t=3 cm 3440 m²,

Asfaltoshtruese (copë 1)

Për hedhjen ,përhapjen shtrimin e shtresës së binderit dhe asfaltobetonit. Në preventiv kemi shtresë binderi t=5 cm 3440 m², shtresë binderi t=6 cm 735 m², shtresë asfaltobetoni t=3 cm 3440 m²,

Fabrikë asfaltobetoni (copë 1)

Prodhimi i asfaltobetonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit të tij. në bazë të preventivit janë shtresë binderi t=5 cm 3440 m², shtresë binderi t=6 cm 735 m², shtresë asfaltobetoni t=3 cm 3440 m²,

Traktor Tërheqës (copë 1)

Për spostimin e shtyllave elektrike. Në preventiv kemi spostim shtylla elektrike 10 copë.

Autovinç deri 5 ton (copë 1)

Për spostimin e shtyllave elektrike. Në preventiv kemi spostim shtylla elektrike 10 copë. Krah shtylla metalike 31 copë.

Spërkatës boje për vizime në rrugë (copë 1)

Për vizimin e sinjalistikës horizontale. Në preventiv kemi vizime me bojë t=15 cm 1695 ml, vizime me bojë 75 m².

Ekskavator min 2 m³ (copë 1)

Për realizimin e zërit mbushje me material të gërmuar në trupin e rrugës. Në preventiv kemi mbushje me material të gërmuar 450 m³, mbushje me çakëll e gur gurore 310 m³,

Kamionçinë deri 3.5 ton (copë 2)

Mjet që përdoret për transportin e materialeve të imëta sjelljen e tyre në objekt dhe transportin e materialeve të ndryshme brenda kantierit si: tabela të ndryshme rrugore 16 copë, konstruksione metalike të thjeshta 5 ton, shtresë zhavor lumi t=10 cm 6m², hekur betoni Ø6-10mm 0.16 ton, hekur betoni Ø>12mm 1.8 ton, hidroizolim me 2k katrama 12 m², tuba PVC f=200 mm 250 ml, elementët e pusetave të shiut 10 copë, elementët e linjës së ndriçimit.

Vibrator (copë 1)

Kërkohet për vibrimin e betonit. Në preventiv kemi struktura monolite betoni C 16/20 - 50 m³, struktura monolite betoni me çakëll C 25/30 - 16 m³, mure butobetoni C 16/20 - 55 m³, puseta kontrolli 30 copë, puseta shiu 10 copë,

Autobetoniere (copë 2)

Për transportin e betonit të marrë nga nyjet e prodhimit të betonit si dhe për të patur cilësi të betonit. Në preventiv kemi struktura monolite betoni C 16/20 - 50 m³, struktura monolite betoni me çakëll C 25/30 - 16 m³, shtresë betoni C 16/20 - 89 m³,

Fabrikë betoni (copë 1)

Prodhimi I betonit të kryhet në fabrikë për të ruajtur një cilësi dhe uniformitet në kohëzgjatje të prodhimit te tij. Në preventiv kemi struktura monolite betoni C 16/20 - 50 m³, struktura monolite

betoni me çakëll C 25/30 - 16 m³, shtresë betoni C 16/20 - 89 m³, mure butobetoni C 16/20 - 55 m³,

Kallëpe (min 400 m²)

Për realizimin e punimeve të betonit. Në preventiv kemi struktura monolite betoni C 16/20 - 50 m³, struktura monolite betoni me çakëll C 25/30 - 16 m³, mure butobetoni C 16/20 - 55 m³, puseta kontrolli 30 copë,

Fadrom (copë 1)

Mjet që përdoret për shpërndarjen e çakëllit. Në preventiv kemi mbushje me çakëll 655 m³,

Betoniere min 0.5 m³ (copë 1)

Për realizime në sasi dhe detaje të vogla betoni. Në preventiv kemi puseta kontrolli 30 copë, puseta shiu 10 copë

Elektrosaldatrice (copë 1)

Për saldimin e kangjellave mbrojtëse, Në preventiv janë 5 ton konstruksione metalike të thjeshta.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.*

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike”, sjellim ne vemendje se:

Disponimi i punonjësve dhe i mjeteve/pajisjeve të kërkuara do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit(shtojca8) gjatë fazës së ofertimit.

Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit për disponimin e punonjësve, mjeteve/pajisjeve do të jete kusht s'kualifikimi.

Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bere gjate fazes se ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike dhe kriteret për kualifikim për procedurën respektive janë hartuar dhe venë në dispozicion për njësinë e prokurimit nga Grupi i Punës, i ngritur me Urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor me nr. 06 datë 07/01/2025

Specifikimet teknike janë sipas materialit i cili është publikuar sebashku me dokumentat e tenderit të hartuara nga specialistët e fushës . pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Lushnjë, në përputhje me detyrat funksionale që ajo ushtron.

- Fondi limit për këtë prokurim është përlogaritur mbështetur në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve”
- Udhëzimin nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.
- Kodet e profesionit janë bazuar në vendimin nr.514, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar.
- Kërkohej prezenca e stafit teknik për realizimin e punimeve pa përcaktuar marrëdhëniet juridike të punësimit gjithashtu mënyra se si sigurohen këto makineri(pronësi, qera apo aktmarrëveshje furnizimi) nuk është përgjegjësi e këtij komisioni.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.mjaftueshme,

e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike janë hartuar për çdo ze punimi të kësaj veprimi sipas preventivit të hartuar nga projektuesi.

NJËSIA E PROKURIMIT: